LIGJ
Nr.8428, datë 14.12.1998

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.7827, DATË 31.5.1994 "PËR AVOKATINË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 11 të ligjit nr.7827, datë 31.5.1994 "Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë" shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

"Avokatëve të zgjedhur anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për kohën që mbajnë këtë detyrë, u ndalohet ushtrimi i profesionit të avokatit në hetimin dhe gjykimin e çështjeve pranë gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2281, datë 24.12.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani